



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.7

10 shkurt

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.6388 datë 27.1.2010	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	221
Vendim i KM nr.24, datë 20.1.2010	Për ngritjen e grupeve të punës për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut e përmbytjet në qarkun e Shkodrës e atë të Lezhës	221
Vendim i KM nr.28, datë 20.1.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.248, datë 27.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, të ndryshuar	227
Vendim i KM nr.29, datë 20.1.2010	Për krijimin e Komisionit Qendror të Përhershëm, për kthimin në atdhe të eshtrave të personaliteteve të shquara shqiptare.....	229
Vendim i KM nr.31, datë 20.1.2010	Për miratimin e lejes për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, Kallmet/Lezhë, (Shqipëri) - Zapponeta/Manfredonia, (Itali).	230
Vendim i KM nr.33, datë 20.1.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.560, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e disa mjediseve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Integritit për ushtrimin e veprimtarisë”	233
Vendim i KM nr.34, datë 20.1.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Lunxhëri të qarkut të Gjirokastrës...	234
Vendim i KM nr.35, datë 20.1.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Mesopotam të qarkut të Vlorës.....	235

Vendim i GJK nr.1, datë 25.1.2010	Me objekt shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.737, datë 30.5.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) dhe i vendimit nr.223, datë 23.02.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë.....	236
Vendim i ERE nr.1, datë 20.1.2010	Për licencimin e shoqërisë “Cez Trade Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	241
Vendim i ERE nr.2, datë 20.1.2010	Për licencimin e shoqërisë “Cez Trade Albania” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike..	242
Vendim i ERE nr.3, datë 20.1.2010	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	242
Vendim i ERE nr.4, datë 20.1.2010	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike	243
Vendim i ERE nr.5, datë 20.1.2010	Për ndryshimin e licencës nr.16, seria PV04P, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.39, datë 22.7.2004 për shoqërinë “Wts Energji” sh.p.k., të ndryshuar	244
Vendim i ERE nr.6, datë 20.1.2010	Për ndryshimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Hidroinvest 1” sh.p.k. me seri PV08K, nr.66, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.113, datë 24.9.2008	245
Vendim i ERE nr.7, datë 25.1.2010	Për dhënie ndihme financiare për zonat e përmbytura në qarkun Shkodër dhe Lezhë	246
Kërkesë e MPPTT nr.478, datë 25.1.2010	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rragam-Kam-Tropojë“	246
Kërkesë e MPPTT nr.9413/4, datë 1.2.2010	Për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme që preken nga “Ndërtimi i linjës së tensionit të lartë 400 kv, Tiranë 2 – Elbasan 2”	247
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur dhe më pas të vdekur të shtetasit Ramazan Llani.....	253

DEKRET
Nr.6388, datë 27.1.2010

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Tahir Mehmed Basha (Rexhepi)
2. Bujar Kadri Hajruli
3. Oxana (Oksana) Constantin Lesaj (Moiseeva)
4. Nail Ali Kemal Şenel
5. Flavia Virgilio Loi
6. Armando Giuseppe Pietro Pezzoni
7. Coşkun Cemal Erden
8. Kadir Ahmet Ekrem
9. Fayyaz Bashir Ahmed
10. Adelina Faik Aliu
11. Aymen Abdelhafid Beldi
12. Doğan Aslan Çil
13. Atila Gjuladin Gjuladin
14. Driton Rahim Bytyqi
15. Eva Ladislav Dragoshi (Lukovicsová)
16. Miaomiao Wenshu Malaj (Li)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM

Nr.24, datë 20.1.2010

PËR NGRITJEN E GRUPEVE TË PUNËS, PËR EVIDENTIMIN DHE VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RESHJET E SHIUT E PËRMBYTJET, NË QARQET E SHKODRËS E TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010” dhe të shkronjës “dh” të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e grupeve të punës, për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut e përmbytjet, në qarkun e Shkodrës dhe atë të Lezhës, përkatësisht, për bashkitë dhe komunat e mëposhtme:

a) Në qarkun e Shkodrës, bashkia Shkodër dhe komunat: Ana e Malit, Dajç, Guri i Zi, Bërdicë, Bushat, Velipojë, Qendër Malësi e Madhe, Rrethina;

b) Në qarkun e Lezhës, komunat Shëngjin, Shënkoll, Fushë-Kuqe.

2. Grupet e punës, sipas komunave, të kenë në përbërje specialistë, të përcaktuar nga ministritë dhe institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Brendshme, 6 specialistë;
- Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, 24 specialistë;
- Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, 24 specialistë;
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, 12 specialistë;
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 12 specialistë;
- Ministria e Shëndetësisë, 12 specialistë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, në Ministrinë e Brendshme, 10 specialistë;
- ALUIZNI, 24 specialistë;
- Këshilli i qarkut të Shkodrës, 22 specialistë;
- Këshilli i qarkut të Lezhës, 6 specialistë;
- Komunat e prekura nga përmytja, nga 1 specialist secila.

3. Grupet e punës të drejtohen nga këshillat përkatëse të qarqeve të sipërpërmendura.

4. Emrat e përfaqësuesve të ministrive e të institucioneve për grupet e punës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, t'i dërgohen, brenda 2 (dy) ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit, Ministrisë së Brendshme dhe Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile.

5. Kryerja e evidentimit dhe e vlerësimit të dëmeve në ndërtesa banimi, në objekte të biznesit, objekte sociale dhe publike, të orendive e të pajisjeve elektroshtëpiake, të dëmeve të shkaktuara në kultura bujqësore, në gjënë e gjallë dhe në bazën ushqimore për blegtorinë, të bëhet sipas formularëve tip 1, 2 e 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

6. Formularët e plotësuar nga grupet e punës për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve, së bashku me listën emërore të pronarëve të banesave apo objekteve të tjera, shoqëruar me certifikatën e kryefamiljarit dhe fotokopjen e dokumentit të identifikimit, t'i dërgohen, nga këshilli i qarkut përkatës, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Ministrisë së Brendshme, pas miratimit nga ministritë e linjës dhe institucionet përkatëse, sipas fushave të veprimtarisë që ato mbulojnë.

7. Ministria e Brendshme paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave vlerën e dëmeve të shkaktuara nga përmytja, së bashku me listën emërore të kryefamiljarëve të dëmtuar, të detajuar sipas objekteve të përcaktuara (ndërtesa banimi, ndërtesa publike, ndërtesa me karakter bujqësor, makineri dhe pajisje, pajisje elektroshtëpiake, orendi e mobilie, kultura bujqësore, gjë e gjallë dhe bazë ushqimore etj.), sipas formularëve të plotësuar, të miratuar nga ministritë e linjës dhe institucionet përkatëse, sipas fushave të veprimtarive që ata mbulojnë dhe të dërguar nga këshillat përkatëse të qarkut Shkodër dhe qarkut Lezhë.

8. Pas vlerësimit të dëmeve për kategoritë e dëmtimeve në ndërtesat e banimit, në objektet e biznesit, në ndërtesat me karakter bujqësor etj., llogaritja të bëhet me çmimet sipas zërave të punimeve të ndërtimit, miratuar për qytetin e Shkodrës apo Lezhës, për vitin 2008, nga Enti Kombëtar i Banesave.

Çmimet për të gjitha zërat e punimeve t'i dërgohen zyrtarisht nga Enti Kombëtar i Banesave këshillave të qarqeve përkatëse.

9. Për objektet e biznesit, vlerësimi i dëmeve në makineri, mallra dhe pajisje të dëmtuara të kryhet në përputhje me dokumentacionin e depozituar pranë organeve tatimore dhe doganore. Vlerësimi të bëhet nga drejtoritë përkatëse rajonale të tatimeve.

10. Vlerësimi për orenditë dhe pajisjet e dëmtuara në ndërtesat e banimit të kryhet, si më poshtë vijon:

- Për grupin pajisje elektroshtëpiake, vlerësimi të bëhet në bazë të çmimit aktual, të përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

- Për grupin orendi e mobilie, të bëhet dëmshpërblimi në lekë, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për frymë, dhe jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë.

11. Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në të mbjella, në gjënë e gjallë dhe në bazën ushqimore (koncentrate, sanë, njomishte etj.), të kryhet sipas çmimeve të tregut, të marra nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

12. Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në objekte sociale e publike (shkolla, spitale, qendra shëndetësore, kabina të tensionit të lartë, ujësjellës, hidrovore, argjinatura dhe rrugë), të kryhet nga specialistët përkatës, anëtarë të grupeve të punës, sipas çmimeve të marra nga ministrinë e linjës për sektorët e përmendur më lart.

Efektet financiare, që rrjedhin në këtë rast, të përballohen nga buxhetet përkatëse, miratuara për ministrinë e linjës.

13. Efektet financiare të dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut dhe përmbytjet në qarkun e Shkodrës e atë të Lezhës të përballohen nga fondi i emergjencave civile në qarkun e Shkodrës dhe, në rastet kur ky fond emergjence nuk është i mjaftueshëm, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

14. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Shëndetësisë, prefekt i qarkut të Shkodrës e ai i Lezhës dhe njësitë përkatëse të qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULARI NR.1

SITUACION VLERËSIMI (NDËRTEA)

Emri, atësia, mbiemri _____
Nr.i dokumentit të identifikimit _____

Njësia vendore _____
Vendbanimi, lagja _____ Fshati _____

Banesa rezulton me dëmtime _____

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					
13					
	Shuma totale				

Vlerësimi bëhet me çmimet e miratuara të EKB-së për qytetin _____

KOMISIONI I VLERËSIMIT

Përfaqësuesi i MPPTT _____
Përfaqësuesi i ALUIZNIT _____
Përfaqësuesi i komunës/bashkisë _____
Përfaqësuesi i qarkut _____
Përfaqësuesi i emergjencave civile _____

FORMULARI NR.2

SITUACION VLERËSIMI (ORENDI E MOBILIE +PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE)

Emri, atësia, mbiemri _____
Nr.i dokumentit të identifikimit _____

Njësia vendore _____
Vendbanimi, lagja _____ Fshati _____

Banesa rezulton me dëmtime _____

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
	Shuma totale				

Vlerësimi bëhet me çmimet e konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

KOMISIONI I VLERËSIMIT

Përfaqësuesi i MPPTT _____
Përfaqësuesi i ALUIZNIT _____
Përfaqësuesi i komunës/bashkisë _____
Përfaqësuesi i qarkut _____
Përfaqësuesi i emergjencave civile _____

MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT

FORMULAR NR.3

Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet në bujqësi në qarqet Shkodër dhe Lezhë

Emri, mbiemri i fermerit _____

Fshati _____

Komuna _____

Qarku _____

I. Dëme të shkaktuara në kulturat bujqësore të arave

Nr.	Kulturat	Sipërfaqe e dëmtuar ha	Shkalla e dëmit në % ndaj sipërf. totale	Rend. Kv/ha	Prodhimi i dëmtuar kv	Çmimi lekë/kv	Vlera e dëmit gjithsej lekë
1	Grurë			40		3000	
2	Lakër koke			320		2500	
3	Qepë e njomë			200		5000	
4	Pras			280		4000	
5	Sallatë (në serë)			200		10000	
6	Spinaq (në serë)			200		9000	
7	Jonxhë			400		600	
8	Foragjere të tjera (hasëll)			250		500	
	Shuma I						

II. Dëme të shkaktuara në pemë frutore, hardhi, ullinj

Nr.	Kultura	Njësia	Dëmtuar, gjithsej rrënjë	Vlera lekë/rrënjë	Vlera lekë, gjithsej
1	Pemë frutore të reja			4500	
2	Pemë frutore në prodhim të plotë			6000	
3	Ullinj të rinj			7800	
4	Ullinj në prodhim të plotë			12700	
5	Hardhi të reja			1250	
6	Hardhi në prodhim të plotë			1500	
	Shuma II				

III. Dëme të shkaktuara në kafshët bujqësore

Nr.	Lloji i kafshës (kategoria)	Njësia	Dëmtuar, gjithsej	Nr.i artikullit i gjedheve	Vlera për kokë (lekë)	Vlera e dëmit gjithsej (lekë)
1	Lopë race				140.000	
2	Lopë vendi				90.000	
3	Mushqerë				110.000	
4	Viça				40.000	
5	Dele				13.000	
6	Rrurëza (Milore)				8.000	
7	Qengja				2500	
8	Dhi				12.000	
9	Ftuja				9000	
10	Keca				2500	
11	Dosa/harça				25000	
12	Derra				10 000	
13	Gica 0-3 muaj				4000	
14	Kalë				45 000	
15	Pelë				65 000	
16	Mushkë				45 000	
17	Gomar				10 000	
18	Mëz				10 000	
19	Pula fushe				1000	
20	Pula deti				3500	
21	Shpendë uji				1300	
22	Zogj				100	
23	Koshere blete				25 000	
	Shuma III					

IV. Dëme të shkaktuara në bazën ushqimore të blegtorisë

Nr.	Lloji i gjësë së gjallë	Numri i krerëve	Nevoja për krerë				Vlera lekë
			Koncentrate		Të thata		
			Sasia kg/krerë	Çmimi lekë/kg	Sasia kg/krerë	Çmimi lekë/kg	
1	Gjedhë		270	26	900	23	
2	Të imëta		27	26	180	23	
3	Derra		180	26	-	-	
4	Njëthundrakë		180	26	360	23	
5	Shpendë		10	26	-	-	
	Shuma IV						

V. Dëme të shkaktuara në ndërtesa me karakter bujqësor

Nr.	Emërtimi	Njësia	Dëmtuar, gjithsej	Vlera për njësi lekë	Vlera e dëmit gjithsej lekë
1	Sera				
2	Hangar				
3	Stalla				
	Shuma V				

VI. Dëme të shkaktuara në bimë dekorative

Nr.	Kultura	Njësia	Dëmtuar, gjithsej rrënjë	Vlera lekë/rrënjë	Vlera lekë gjithsej
1	Bimë dekorative 1-2 vjeçare			300	
2	Bimë dekorative 3-4 vjeçare			400	
3	Bimë dekorative 4 - vjeçare			600	
	Shuma VI				

SHUMA I+II+III+IV+V+VI _____

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1 _____ 2 _____ 3 _____

4 _____ Fermeri _____

MIRATOHET

VENDIM

Nr.28, datë 20.1.2010

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.248, DATË 27.4.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 11 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.248, datë 27.4.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1, fjalët “... në varësi të Kryeministrit...” zëvendësohen me “... në varësi të Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin...”.

b) Pikat 2 dhe 3 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) ka objekt të veprimtarisë:

a) Zbatimin e politikave e të strategjive, për zhvillimin e sektorit të shoqërisë së informacionit (më poshtë SHI) dhe në veçanti të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (më poshtë TIK);

b) Bashkërendimin e programeve në fushën e SHI-së dhe në veçanti të TIK-ut;

c) Nxitjen e investimeve në fushën e SHI-së;

ç) Hartimin e praktikave për ushtrimin e kompetencave që i jepen ministrit nga legjislacioni në fushën e komunikimeve elektronike;

- d) Promovimin e teknologjive të reja në fushën e SHI-së;
- dh) Dhënien e kontributit në edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK-ut nga publiku.

3. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka këto detyra dhe përgjegjësi specifike:

a) Merr pjesë në hartimin e strategjisë kombëtare për zhvillimin e shoqërisë së informacionit dhe bashkërendon punën për zbatimin e saj;

b) Merr pjesë në hartimin e dokumentit të politikës së zhvillimit në fushën e komunikimeve elektronike;

c) Merr pjesë në përgatitjen e bazës ligjore për zhvillimin e SHI-së dhe të TIK-ut;

ç) Ndihmon në hartimin e ndryshimeve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën e komunikimeve elektronike;

d) Bashkërendon reformat, programet dhe projektet në fushën e SHI-së, që zbatohen në të gjitha institucionet publike;

dh) Përcakton standardet e TIK-ut, që do të përdorë Kryeministria, ministritë dhe institucionet, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit/ministrit. Këto standarde botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike;

e) Në rastet kur standardet mungojnë dhe/ose janë të pazbatueshme, institucionet e mësipërme janë të detyruara, në çdo rast, të marrin mendimin e AKSHI-t, përpara fillimit të procedurave të prokurimit publik;

ë) Zhvillon një rrjet të brendshëm të TIK-ut për administratën publike, përfshi krijimin e rrjetit qeveritar (GovNet) dhe të portalit qeveritar;

f) Bashkërendon projektet për futjen e kompjuterave në të gjithë sektorët e administratës publike, duke i dhënë përparësi institucioneve, që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për publikun dhe bizneset;

g) Drejton strategjinë dhe projektet për ngritjen e shërbimeve *on line* të administratës publike, përfshi të gjitha shërbimet e qeverisjes elektronike;

gj) Mbështet dhe bashkërendon projektet për dixhitalizimin e bazës ligjore, të dokumentacionit, të arkivave, të bibliotekave etj.;

h) Nxit dhe mbështet përdorimin e internetit dhe TIK-ut në shkolla, përfshi kompjuterizimin dhe aksesin në internet të të gjitha shkollave publike;

i) Nxit dhe mbështet zhvillimin e biznesit *on line* (e-bussiness);

j) Nxit dhe mbështet politika për zhvillimin e infrastrukturës së TIK-ut dhe të investimeve private në këtë fushë;

k) Promovon përhapjen e internetit dhe aksesin e publikut në shërbimet *on line*;

l) Promovon dhe mbështet rritjen e aftësive për përdorimin e kompjuterit dhe të internetit nga qytetarët;

ll) Bashkëpunon në fushën e SHI-së me institucione të tjera shtetërore dhe ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat;

m) Bashkërendon veprimtarinë dhe përgatit praktikat në kuadër të detyrimeve, konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, dypalëshe dhe shumëpalëshe, në fushën e komunikimeve elektronike.

Ministria e Financave, gjatë planifikimit të projektbuxhetit të shtetit, duhet të marrë mendimin e AKSHI-t, i cili është organ teknik-këshillimor i institucioneve të përmendura në shkronjën “dh” të pikës 3 të këtij vendimi, për kërkesat e tyre, për financimin me fonde buxhetore të projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.”.

c) Pas pikës 3, shtohen pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, me këtë përmbajtje:

“3.1. Veprimtaria e AKSHI-it mbështetet nga këshilli koordinativ, si organ kolegjal, i kryesuar nga Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, dhe në përbërje të tij janë:

a) zëvendësministri i Brendshëm;

b) zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës;

c) zëvendësministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

ç) rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës;

- d) këshilltari i Kryeministrit për çështjet e shoqërisë së informacionit;
 dh) deri në katër funksionarë e personalitete të fushës, të emëruar nga kryetari i tij.
- 3.2. Funksionet kryesore të këshillit koordinativ janë:
- a) Shqyrtimi i projektakteve, ligjore e nënligjore, i dokumenteve strategjike dhe akteve të tjera, që lidhen me shoqërinë e informacionit;
- b) Diskutimi i projektbuxhetit për shoqërinë e informacionit, përfshirë edhe fondet për funksionimin e AKSHI-t;
- c) Vlerësimi i procedurave për përzgjedhjen dhe financimin e projekteve të programit të dixhitalizimit;
- ç) Shqyrtimi i raporteve të veprimtarisë së AKSHI-t;
- d) Shqyrtimi i raporteve të monitorimit dhe të vlerësimit të programeve, të financuara nga AKSHI.

3.3 Këshilli koordinativ mblidhet jo më pak se gjashtë herë dhe jo më shumë se dhjetë herë në vit.”.

ç. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. AKSHI drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e AKSHI-t, dhe raporton para Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin.

Drejtori i Përgjithshëm i AKSHI-t emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin.”.

2. Ngarkohet Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.29, datë 20.1.2010

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT QENDROR TË PËRHERSHËM, PËR KTHIMIN NË
 ATDHE TË ESHTRAVE TË PERSONALITETEVE TË SHQUARA SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit Qendror të Përhershëm, për përjetësimin e veprës dhe të kontributit në dobi të atdheut të personaliteteve dhe të figurave të shquara kombëtare.

2. Ky komision të kryesohet nga Ministri i Brendshëm dhe të ketë në përbërje këta anëtarë:

- zëvendësministrin e Punëve të Jashtme;
- zëvendësministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- sekretarin e Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme;
- drejtorin e Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Gjithashtu, komisioni fton, në cilësinë e anëtarit pa të drejtë vendimmarrjeje, sipas rastit, edhe 1 përfaqësues të familjes së personalitetit.

3. Komisioni, nëpërmjet Ministrit të Brendshëm, propozon për miratim projektaktet përkatëse, në Këshillin e Ministrave, për kthimin në atdhe të eshtrave dhe organizimin e ceremonisë zyrtare për personalitetet dhe figurat e shquara kombëtare, për çdo rast.

4. Efektet financiare që rrjedhin, sipas rastit, të përballohen nga buxheti i miratuar për ministrinë, fushës së të cilës i përket personaliteti.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Komisioni Qendror i Përhershëm dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.31, datë 20.1.2010

**PËR MIRATIMIN E LEJES PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E LINJËS
TREGTARE TË INTERKONJEKSIONIT, ME RRYMË TË VAZHDUAR,
KALLMET/LEZHË, (SHQIPËRI) - ZAPPONETA/MANFREDONIA, (ITALI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31 e 31/1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të linjës tregtare të interkonjeksionit me rrymë të vazhduar, Kallmet/Lezhë, (Shqipëri) – Zapponeta/Manfredonia, (Itali).

2. Miratimin e lejes nr.4/1, datë 7.12.2009 “Për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit me rrymë të vazhduar, Kallmet/Lezhë (Shqipëri)-Zapponeta/Manfredonia, (Itali), dhënë nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k.-së, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi nr.1515, datë 19.11.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e lejes për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, Kallmet/Lezhë, (Shqipëri) – Zapponeta/Manfredonia, (Itali)”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

Në mbështetje të neneve 31 dhe 31/1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.529, datë 15.8.2007 “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit”, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.725, datë 7.11.2007 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.529, datë 15.8.2007 “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit”,

i jepet shoqërisë anonime “Biopower Green Energy” sh.p.k, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë, me nr. serial SN -004412-12-07, më datë 5.12.2007 dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me numër nipti: K72405024M, me seli në Tiranë, rruga “Sulejman Delvina”, Qendra e Biznesit Zayed.

LEJE
Nr. 4/1, datë 7.12.2009

**PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E LINJËS TREGTARE TË
INTERKONJEKSIONIT, ME RRYMË TË VAZHDUAR, NDËRMJET KALLMET/LEZHË
(SHQIPËRI) DHE ZAPPONETA/MANFREDONIA (ITALI)**

Leja jepet për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, qarku Lezhë, komunat Kallmet dhe Shëngjin (Shqipëri) – rajoni i Pulias, komuna e Manfredonias dhe Foggias (Itali), pa akses të palëve të treta.

Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. ka të drejtën e shfrytëzimit të kapacitetit të kësaj linje vetëm pasi të ketë vënë në punë parkun e erës dhe/ose centralin me biomasë, për prodhimin e energjisë elektrike në zonën e Lezhës.

Karakteristikat kryesore të linjës janë:

- Linjë e tensionit të lartë e rrymës së vazhduar;
- Drejtimi i kalimit të energjisë do të jetë në të dy drejtimet: Shqipëri-Itali dhe Itali-Shqipëri;
- Tensioni nominal do të jetë: $U_n = 500 \text{ kV}$;
- Kapaciteti total i fuqisë transmetuese të kësaj linje është 1000 MW;
- Kapaciteti minimal i fuqisë është: $P_{min} = 10 \% \text{ e } P_n$;

Puna për ndërtimin e linjës duhet të fillojë brenda 18 (tetëmbëdhjetë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj lejeje.

Leja hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj lejeje, duhet të lidhë një kontratë me OST sh.a.-në, për mënyrën e ndërtimit dhe të funksionimit të linjës tregtare të interkonjeksionit.

Pika e lidhjes së rrjetit elektrik, të ndërtuar nga shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., me sistemin elektroenergjetik shqiptar do të jetë konform kontratës, që kjo shoqëri do të lidhë me OST sh.a.

Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., para fillimit të punimeve, duhet të depozitojë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dokumentet përkatëse, që vërtetojnë mbështetjen financiare për realizimin e këtij projekti.

Koha e realizimit të projektit për ndërtimin e kësaj linje, lidhjen me sistemin elektroenergjetik shqiptar dhe vënia në shfrytëzim do të jetë 4 (katër) vjet nga data e fillimit të punës për ndërtimin e saj.

Fillimi i punës për ndërtimin e linjës konsiderohet data e nënshkrimit të një procesverbali ndërmjet shoqërisë «Biopower Green Energy” sh.p.k., me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pas paraqitjes nga ana e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., te kjo Ministri, të dokumentacionit përkatës.

Leja i jepet shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit për një afat 20-vjeçar, nga data e vënies në punë të saj.

Data e vënies në punë të linjës konsiderohet data e nënshkrimit të një procesverbali ndërmjet shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pas paraqitjes nga ana e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., te kjo Ministri, të dokumentacionit përkatës.

Leja jepet me të drejtën që shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., të përdorë 80 % të kapacitetit transmetues të kësaj linje dhe 20% e kapacitetit transmetues të kësaj linje i jepet për shfrytëzim pa pagesë OST sh.a., Shqipëri.

Në rastet kur linja tregtare e rrymës së vazhduar punon e ndarë nga Sistemi elektroenergjetik shqiptar, atëherë shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., është e detyruar t'i kalojë OST sh.a., 20 % të fitimit të realizuar nga shfrytëzimi 20% i kapacitetit të kësaj linje.

Për të gjithë kohëzgjatjen e lejes, edhe sikur të jetë një situatë e kapaciteteve të limituara, shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., do t'i sigurojë falas OST sh.a.-së, kuotën e

kapaciteteve, për të cilën nuk i është dhënë përjashtimi nga aplikimi i së drejtës për akses të palëve të treta.

Gjatë të gjithë periudhës së ndërtimit dhe të funksionimit të linjës së interkonjeksionit, shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., është e detyruar të respektojë të gjithë kuadrin ligjor dhe rregullator të sektorit të energjisë elektrike.

Të gjitha asetet që mundësojnë funksionimin e kësaj linje dhe kalimin e energjisë elektrike nga njëri vend te tjetri, në fund të periudhës së lejes, i kalojnë OST sh.a.-së në Shqipëri pa pagesë.

Pjesa e rrjetit, që do të ndërtohet nga “Biopower Green Energy” sh.p.k., për të realizuar lidhjen e linjës tregtare të interkonjeksionit me rrjetin ekzistues të transmetimit, që në ndërtimin e saj, do të jetë pjesë e rrjetit kombëtar të transmetimit, dhe kalon në pronësi të OST sh.a. -së, pa pagesë.

OST sh.a. nuk është e detyruar të tranzitohet në rrjetin e administruar prej saj energjinë elektrike të prodhuar nga centralët elektrike të shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k.

OST sh.a. nuk është e detyruar të tranzitohet, në rrjetin e administruar prej saj, energji elektrike të siguruar nga burime të tjera gjeneruese brenda apo jashtë Shqipërisë dhe që duhen transmetuar në drejtim të Italisë nëpërmjet kësaj linje tregtare interkonjeksioni, për llogari të shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k.

Leja konsiderohet automatikisht e revokuar në rastet kur:

1. Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. nuk paraqet brenda një periudhe prej 18 muajsh, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj lejeje të gjithë dokumentacionin, autorizimet apo lejet e ndryshme, që kërkohen për ndërtimin e kësaj linje.

2. Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. nuk depoziton pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda një periudhë 18-mujore nga data e hyrjes në fuqi të kësaj lejeje, dokumentet përkatëse që vërtetojnë mbështetjen dhe garancinë financiare për realizimin e këtij projekti.

3. Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. nuk paraqet, para fillimit të punimeve për ndërtimin e kësaj linje, dokumentacionin përkatës që provon fillimin e ndërtimit të ndonjërit prej burimeve gjeneruese të energjisë elektrike, për transmetimin e tsë cilës është kërkuar ndërtimi i kësaj linje.

4. Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. nuk fillon punën në afatin e parashikuar në këtë leje.

5. Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. nuk përfundon në afatin e përcaktuar në këtë leje realizimin e plotë të projektit për ndërtimin e kësaj linje, lidhjen me sistemin elektroenergjetik shqiptar, sipas skemës të rënë dakord me OST sh.a.-në, dhe vënien në punë të tyre.

Për rastet kur “Biopower Green Energy” sh.p.k. nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në shkronjat “d”, “ë” dhe “f” të pikës 2.3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.529, datë 15.8.2007 “Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit”, si dhe nuk merr masat e menjëhershme për sigurimin e sistemit elektrik kombëtar, ministria i jep 30 ditë kohë për të përmbushur detyrimet.

Nëse shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., përsëri nuk i përmbush ato, atëherë leja e dhënë revokohet.

Kohëzgjatja e kësaj lejeje është 20 vjet, duke filluar nga data e vënies në punë të kësaj linje.

Kjo leje nuk do të zëvendësojë ndonjë kompetencë të ndonjë autoriteti ose institucioni tjetër shtetëror ekzistues për të dhënë leje, pëlqimin ose çdo dokument tjetër që kërkohet, sipas legjislacionit në fuqi.

VENDIM
Nr.33, datë 20.1.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.560, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN E DISA MJEDISEVE NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
TË MINISTRISË SË INTEGRIMIT PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË”


Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.560, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 1 fjalët “1340 m²” zëvendësohen me “1556 m²”.
 - b) Aneksi nr.1, që i bashkëlidhëj vendimit, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Ministri i Integrimit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi nr.1



VENDIM
Nr.34, datë 20.1.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS LUNXHËRI TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Lunxhëri të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Lunxhëri të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.702, datë 19.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Lunxhëri të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Lunxhëri për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Lunxhëri	Lidhja nr.1	
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	
Lidhja nr.1	Lloji i transferimit	
1-5	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve të arsimit.	Në pronësi
6	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e kulturës dhe sportive.	Në pronësi
8	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë.	Në pronësi
10-14	Shërbime funerale	Në pronësi
15-446	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike	Në pronësi
447-449	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
450-451	Prona që përdoren në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm.	Në pronësi
502-504,506-508,510-511,513-514,516-517,519-520,522-523,525-527,529-530,532-533	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë (tokë bujqësore produktive).	Në përdorim
505,509,512,515,518,521,524,528,531,534	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë (tokë bujqësore joproduktive).	Në përdorim
535-543,550-556	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë.	Në pronësi
563-633 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e kullimit dhe ujitjes.	Në pronësi
635-700	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit të turizmit dhe administrimi i burimeve ujore.	Në pronësi

VENDIM
Nr.35, datë 20.1.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS MESOPOTAM TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Mesopotam të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Mesopotam të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr.1326, datë 1.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Mesopotam të qarkut të Vlorës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Mesopotam për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Mesopotam	Lidhja nr.1	
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
202-214	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve të arsimit.	Në pronësi
215-226	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë.	Në pronësi
227-241	Shërbime funerale	Në pronësi
242-541,588-804	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike.	Në pronësi
542-543	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në administratë.	Në pronësi
544,549-587	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e kulturës dhe sporteve.	Në pronësi
808-841 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren në fushën e kullimit dhe të ujitjes. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm.	Në pronësi
842-844,846-848,850-852,854-857,859-861,863-864,866-868,871-873,875-877,879-880,882-884.	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë (tokë bujqësore produktive).	Në përdorim
845,849,853,858,862,865,869,870,874,878,881,885	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë (tokë bujqësore joproduktive).	Në pronësi
886-900	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm.	Në pronësi

VENDIM
Nr.1, datë 25.1.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 24.9.2009 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 20/11 Akti, që i përket:

KËRKUES: KOMUNITETI MYSLIMAN SHQIPTAR, përfaqësuar nga avokat Selfo Dosti, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shyqyri Toska, përfaqësuar nga avokat Baftjar Rusi.

ZYRA RAJONALE E AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE, QARKU TIRANË

Asllan Hida, Ali Rexha

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr. 737, datë 30.5.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) dhe i vendimit nr. 223, datë 23.2.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41/1, 42, 131/f, 132/1, 134/ë dhe 134/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28, 29 dhe 30 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Admir Thanza; përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar Shyqyri Toska që kërkoi rrëzimin e kërkesës; subjektet e interesuar Asllan Hida dhe Ali Rexha që kërkuan pranimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Nga materialet e çështjes rezultojnë se Komuniteti Mysliman Shqiptar (Kërkuar) ka pasur në pronësi të tij një truall me sipërfaqe 150 pashë (pashë – largësia nëpërmjet dy duarve me krahë të shtrirë anash plotësisht; masë gjatësie e barabartë me këtë largësi rreth 1.5 m - ref. “Fjalori i Gjuhës Shqipe” botim i vitit 1980, fq.1382), i ndodhur përballë Medresesë në Tiranë. Ky truall ka qenë i regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë me nr.233, datë 20.03.1919.

Në bazë të vendimeve gjyqësore rezultojnë se në vitin 1967 kjo pronë i është shtetëzuar pa shpërblim kërkuarit nëpërmjet dekreteve nr.4252 dhe nr.4253, datë 11.4.1967 të Presidiumit të Kuvendit Popullor “Për shtetëzimin e pasurisë së paluajtshme të komuniteteve fetare”.

Në bazë të vendimeve gjyqësore të administruara në dosje rezulton, se në vitin 1992 kjo pronë i është blerë Komitetit Ekzekutiv nga Shyqyri Toska me anë të kontratës nr.1856, datë 30.5.1992, dhe është regjistruar në regjistrin hipotekor.

Kërkuesi Shyqyri Toska, në vitin 1993 ka ngritur padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt pushim të cenimit të pronësisë kundër Asllan Hida dhe Ermal Deliu, pasi këta të fundit kishin ndërtuar dy kioska mbi këtë pronë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur të pranojë padinë e paditësit Shyqyri Toska. Mbi ankimin e palës së paditur, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur të lërë në fuqi këtë vendim. Më pas, Gjykata e Kasacionit, me vendimin nr. 1330, datë 5.10.1995 vendosi "... prishjen e vendimeve të dy gjykatave më të ulëta dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë".

Ndërkohë, paralelisht me procedurën e sipërpërmendur, në vitin 1993, Shyqyri Toska i drejtohet me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vërtetimin e faktit të pronësisë së tij mbi truallin 730 m² dhe faktit, që dikur kjo pronë ka qenë në pronësi të babait të tij Sadik Toska. Me anë të vendimit nr. 4689, datë 3.12.1993 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke u mbështetur edhe në kontratën e shitblerjes nr. 1856, datë 30.05.1992, vendosi "... të vërtetojë faktin juridik të pronësisë së Shyqyri Toskës mbi një truall me sipërfaqe prej 730 m² dikur pronë e babait të kërkuetit Sadik Toskës". Me vendimin gjyqësor të sipërpërmendur për vërtetimin e faktit, pala Shyqyri Toska, reregjistron këtë pronë pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Në vitin 1995, me kërkesë të Bashkisë Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 2688, datë 11.5.1995 vendosi "... ta shpallë të pavlefshme kontratën e shitblerjes së datës 30.5.1992 ndërmjet Shyqyri Toskës dhe Komitetit Ekzekutiv". Ky vendim mori formë të prerë, pa u ankimuar nga palët, dhe u ekzekutua duke u bërë çregjistrimi i pronësisë së Shyqyri Toskës.

Në vitin 1996 Sadik Toska i është drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe ka kërkuar kthimin e truallit prej 730 m² me pretendimin se kishte qenë në pronësi të tij. Komisioni, me vendimin nr. 769, datë 23.2.1996 vendosi "... të mos njohë si ish-pronar Sadik Toskën", pasi ky i fundit nuk kishte paraqitur asnjë vërtetim shpronësimi për atë pronë.

Në vazhdim të procedurës gjyqësore, të nisur me anë të padisë së ngritur në datën 17.11.1993 nga Shyqyri Toska me objekt pushim të cenimit të pronësisë, pas dërgimit për rigjykim pranë saj, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 9214, datë 14.11.1996 vendosi të rrëzojë padinë e paditësit Shyqyri Toska duke argumentuar se paditësi nuk legjitimohej, pasi nuk kishte as cilësinë e pronarit, që e kishte humbur me vendim të formës së prerë (vendimi nr. 2688, datë 11.5.1995 me të cilin u anulua kontrata e shitjes), dhe as cilësinë e poseduesit. Me vendimin nr.909, datë 24.2.1997, Gjykata e Apelit Tiranë vendosi lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

Në vitin 2000, për kthimin e kësaj prone, kërkuesi i është drejtuar dhe Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i cili me vendimin nr.197, datë 29.5.2000 vendosi "... t'i njohë pronësinë e truallit, i cili u regjistrua në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme me nr. 187, datë 30.6.2000.

Në vitin 2002 Shyqyri Toska iu drejtua me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt përfundimtar "... anulimin e vendimit nr.197, datë 29.5.2000 të Komisionit për Kthimin dhe Kompensimit të Pronave". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.4120, datë 13.10.2003 vendosi "... të pranojë padinë dhe ta anulojë vendimin nr.197, datë 29.5.2000 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave", pasi vlerësoi se ky vendim ishte marrë në kundërshtim me ligjin.

Pas apelit të çështjes nga kërkuesi, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1484, datë 17.12.2004, vendosi prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, duke vërejtur se paditësi nuk legjitimohej për të ngritur padinë, pasi "... të drejtat e pronësisë për truallin e pretenduar rezulton se janë rrëzuar edhe me vendimin gjyqësor nr.9214, datë 14.11.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim, i cili ka marrë formë të prerë dhe ku të paditur kanë qenë ndërhyrësit dytësor të këtij gjykimi".

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë pala Shyqyri Toska, ushtroi të drejtën e rekursit pranë Gjykatës së Lartë, e cila me vendimin nr.315, datë 23.3.2006 vendosi "... të prishë vendimin e Gjykatës së Apelit dhe të dërgojë çështjen për rigjykim në po atë gjykatë ..." duke

vërejtur, ndërmjet të tjerave, se pala Shyqyri Toska ka vërtetuar faktin e qenies pronar mbi sipërfaqen e pretenduar me anë të një vendimi gjyqësor, të cilin ai e ka regjistruar edhe në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pra, ka një titull pronësie të regjistruar dhe, për këtë arsye, legjitimohet të kundërshtojë vendimin e dhënë nga Komisioni.

Gjykata e Apelit Tiranë, pasi rishqyrtoi çështjen, me vendimin nr.223, datë 23.2.2007 vendosi "... lënien në fuqi të vendimit nr.4120, datë 13.10.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë".

Pas rekursit të ushtruar nga kërkuesi, Gjykata e Lartë, në Dhomën e Këshillimit, me vendimin nr.737, datë 30.5.2008 vendosi mospranimin e rekursit.

Në përbërjen e Dhomës së Këshillimit, e cila mori vendimin e mësipërm, morën pjesë 3 anëtarë që kishin qenë edhe në përbërjen e Kolegjit Civil që dha vendimin nr.315, datë 23.03.2006, i cili vendosi ta prishë vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ta dërgojë çështjen për rigjykim.

Kërkuesi, Komuniteti Mysliman Shqiptar, përpara Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), kërkon shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.737, datë 30.5.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) dhe të vendimit nr.223, datë 23.2.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë me pretendimin se këto vendime janë marrë nëpërmjet një procesi jo të rregullt ligjor duke parashtruar këto argumente:

- Gjykatat nuk kanë respektuar vendime gjyqësore dhe administrative të formës së prerë duke shkelur kështu parimin e sigurisë juridike, i cili presupozon respektimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*).

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) ka shkelur parimin e paanshmërisë në gjykim.

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) i ka mohuar të drejtën për t'u dëgjuar në seancë gjyqësore.

Subjekti i interesuar Shyqyri Toska parashtrroi këto prapësime:

- Nuk është në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar pretendimin e shkeljes së parimit të sigurisë juridike, pasi kërkuesi nuk e ka ngritur këtë pretendim në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë dhe për rrjedhojë, nuk ka shteruar mjetet juridike. Gjithashtu, kërkuesi e ka mbështetur këtë pretendim mbi argumente që lidhen me vlerësimin e provave, gjë që nuk hyn në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese. Nuk është shkelur parimi i sigurisë juridike, pasi vendimet gjyqësore dhe administrative nuk kanë pasur të njëjtin objekt.

- Nuk është shkelur parimi i paanshmërisë në gjykim, pasi Gjykata e Lartë me vendimin nr.315, datë 23.3.2006 nuk ka shqyrtuar çështjen në themel duke prishur vendimin e gjykatës së apelit për të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, por duke konstatuar shkelje të rënda procedurale dhe duke ia nënshtruar debatit mes palëve prishi vendimin e gjykatës së apelit nr.1484, datë 17.12.2004 dhe e ktheu çështjen për rigjykim. Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.737, datë 30.5.2008 nuk ka rigjykuar çështjen, rrjedhimisht, gjyqtarët nuk kanë shfaqur mendim për çështjen në gjykim në kuptim të nenit 74 të Kodit të Procedurës Civile. Nuk është shkelur parimi i paanshmërisë në gjykim, pasi prania e 3 gjyqtarëve të njëjtë gjatë dhënies së vendimeve në Gjykatën e Lartë nuk përbën shkelje të karakterit kushtetues.

- Pretendimi i kërkuesit se i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar në seancë gjyqësore nuk qëndron dhe nuk përbën shkelje të standardeve kushtetuese.

II

Gjykata i vlerëson pretendimet e kërkuesit në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor.

1. Kërkuesi, duke iu referuar nenit 131, shkronja "f" të Kushtetutës, ka pretenduar se i është shkelur e drejta e pronës si pasojë e një procesi jo të rregullt gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit dhe, nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Gjykata Kushtetuese çmon, se në kuptim të nenit 131, shkronja "f" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, individi mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike.

Rregulli i vendosur nga dispozita e mësipërme kushtetuese e detyron kërkuesin, që për zgjidhjen e çështjes së tij, t'u drejtohet të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (shih vendimin nr.17, datë 18.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

2. Lidhur me pretendimin e kërkuesit për shkeljen e parimit të sigurisë juridike si pasojë e mosrespektimit të parimit të gjësë së gjykuar (*res judicata*) nga Gjykata e Lartë dhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, nga shqyrtimi i materialeve të çështjes, Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkuesi nuk e ka ngritur këtë pretendim përpara Gjykatës së Lartë.

Rregulli i shterimit të mjeteve nënkupton jo vetëm që ankuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, por edhe që të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngre në këtë Gjykatë, t'i ketë paraqitur më parë në të gjitha instancat e zakonshme gjyqësore, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural. Duke mos e ngritur këtë pretendim kërkuesi nuk ka shfrytëzuar mjetet efektive për të realizuar ndreqjen e shkeljes së të drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor.

Lidhur me këtë është shprehur edhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (*çështja Akdivar*, etj. – kundër Turqisë; vendimi nr.21893, datë 16.9.1996, vëllimi 1996 – IV), e cila pranon se "... shterimi i mjeteve nënkupton që kërkuesi t'i drejtohet mjeteve që janë efektive dhe të mjaftueshme për të realizuar ndreqjen e shkeljeve të lejuara".

Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkuesi nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike sipas kërkesave të nenit 131, shkronja "f" të Kushtetutës dhe, pretendimi i tij për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e shkeljes së parimit të sigurisë juridike nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata.

3. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit mbi cenimin e parimit të paanshmërisë së trupës së gjyqtarëve që përbënin Dhomën e Këshillimit, Gjykata thekson se analiza duhet zhvilluar nën dritën e jurisprudencës aktuale të vetë kësaj Gjykate, si dhe të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Neni 42, paragrafi 2 i Kushtetutës parashikon se: "Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ... ka të drejtën e një gjykimi të drejtë ... nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj."

Koncepti në shqyrtim është i njohur dhe mbrohet edhe nga aktet ndërkombëtare, si: "Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike", "Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut" (KEDNJ), të ratifikuara nga RSH e, për pasojë, pjesë e së drejtës së brendshme të saj (nenet 116 dhe 122 të Kushtetutës së RSH). KEDNJ në nenin 6 "E drejta për një proces të rregullt", paragrafi "1", parashikon: "Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht ... nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj, e cila do të vendosë ... për konfliktet mbi të drejtat dhe detyrimet me karakter civil"

"Një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor apo të procesit të drejtë të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut është edhe ai i paanshmërisë së gjykatës në gjykimin e çështjes. Në këtë kuadër, Gjykata thekson se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimin nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe duhet të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykuar, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike, duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë" (shih vendimin nr.12, datë 13.4.2007

të Gjykatës Kushtetuese). Karakteri thelbësor i rasteve të papajtueshmërisë i referohet në fakt hipotezës specifike në të cilën vlerësimi paragjykes, megjithëse është shprehur në një proces formalisht të ndryshëm nga aktuali, i përket një ngjarjeje thelbësisht të njëjtë për procesin, që mund, ose duhet të ishte gjykuar në kontekstin e vetë procesit. Paragjykimi eventual për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. (Shih më gjerë vendimet nr. 283/2000 dhe nr. 326/2002 të Gjykatës Kushtetuese të Italisë).

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në Dhomën e Këshillimit në Gjykatën e Lartë (Shih vendimin nr. 4, datë 25.02.2009 të Gjykatës Kushtetuese). Për Gjykatën është konsideruar “gjykatë e anshme” trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili në këndvështrimin objektiv nuk jep garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata ka theksuar se “... thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një apo më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar, se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje”(Shih vendimin nr. 48, datë 30.07.1999 të Gjykatës Kushtetuese).

Në rastin në shqyrtim, kërkuesi ka vënë në dyshim paanësinë e tre gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për shkak se ata kanë marrë pjesë në dy gjykime me palë të njëjta. Gjykata çmon, se në përcaktimin nëse në këtë çështje ka arsye logjike për të dyshuar që këta tre gjyqtarë nuk kanë qenë të paanshëm, këndvështrimi i kërkuesit për këtë pretendim është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtar është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i bazuar.

Nga dokumentet e dosjes gjyqësore rezulton se tre nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë që kanë shqyrtuar në gjykimin e parë rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar, kanë konkluduar se ai legjitimohej për të ngritur padinë, kanë prishur vendimin nr. 1484, datë 17.12.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, për këtë arsye, e kanë dërguar çështjen për rigjykim pranë po asaj gjykate. Po këta gjyqtarë, në gjykimin e dytë, kanë shqyrtuar dhe kanë konkluduar për mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila rigjykoi çështjen. Gjykata vlerëson se, pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve të kërkuesit në të dy gjykimet, ato lidhen me shqyrtimin e të njëjtit fakt, me të njëjtat subjekte, pra me të njëjtin konflikt gjyqësor.

Është detyrë e Gjykatës të konkludojë nëse pjesëmarrja e tre gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dy vendimet e dhëna për të njëjtën rrethanë të pretenduar, (ndërkohë që objektivisht kanë ekzistuar mundësitë për shmangien e tyre nga gjykimi) ka krijuar një dyshim të justifikuar te kërkuesi se vendimi i dhënë ka qenë produkt i një procesi të dyshuar si të njëanshëm.

Si përfundim, Gjykata konkludon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme në perceptimin e publikut, është i drejtë. Për rrjedhojë, kërkesa që i përket pretendimit të dytë të kërkuesit është e bazuar dhe duhet pranuar.

4. Argumentin e tretë të kërkuesit mbi cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nëpërmjet mohimit të së drejtës për t'u dëgjuar në seancë gjyqësore nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) Gjykata Kushtetuese e gjen të pabazuar. Gjykata Kushtetuese është shprehur në mënyrë konstante se është kompetencë e Kolegjit Civil (Dhoma e Këshillimit) të analizojë dhe vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji në Dhomën e Këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “ë” të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr. 737, datë 30.05.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit).

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Vladimir Kristo (Kryetar), Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Admir Thanza.

Anëtarë kundër: Fehmi Abdiu, Vitore Tusha, Sokol Sadushi.

VENDIM

Nr.1, datë 20.1.2010

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “CEZ TRADE ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”, 9 dhe 13, pika 1, germa “d” të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 4, pika 1, germa “g”, neneve 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. ka nisur me marrjen e vendimit nr.84, datë 04.11.2009.

- Dokumentacioni për aplikimin për licencimin për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike është paraqitur i plotë, konform përcaktimeve të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike me afat të vlefshmërisë së licencës 5 vjet.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.2, datë 20.1.2010

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “CEZ TRADE ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGIJË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”, e 9, dhe nenit 45, pikat “3” dhe “4” të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “f”, neneve 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. ka nisur me marrjen e vendimit nr.85, datë 04.11.2009.

- Dokumentacioni për aplikimin për licencimin për kryerjen e aktivitetit të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike është paraqitur i plotë, konform përcaktimeve të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike me afat të vlefshmërisë së licencës 5 vjet.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.3, datë 20.1.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ALPIQ ENERGY ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 13, pikat 1, germa “d”, dhe 8, pika 2, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pikat 1, germa “a”, dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

- Aplikimi i shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.
 2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.4 , datë 20.1.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALPIQ ENERGY ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a” e 9, dhe nenit 45 pikat, “3” dhe “4”, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “f”, neneve 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, nenit 18, pikat 1, germa “a”, dhe 3, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM Nr.5, datë 20.01.2010

PËR NDRYSHIMIN E LICENSËS NR.16, SERIA PV04P, LËSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.39, DATË 22.07.2004 PËR SHOQËRINË “WTS ENERGJI” SHPK, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 15 pika 2 germa “c” të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr.16, seria PV04P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.39, datë 22.7.2004, për shoqërinë “WTS Energji” sh.p.k., të ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 9.4.2009,

dhe konstatoi se:

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “WTS Energy” sh.p.k. ka nisur me marrjen e vendimit nr.82, datë 4.11.2009.
 - Janë paraqitur në përputhje me rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.
 - Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (neni 15, pika 4, germa “a”).
 - Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar ndryshim licence (neni 15, pika 4, germa “b”).
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Ndryshimin e licencës nr.16, seria PV04P, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.39, datë 22.7.2004 për shoqërinë “WTS Energji” sh.p.k., të ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 9.4.2009, duke hequr nga lista e impianteve gjeneruese, në aneksin A, HEC-in Selcë.
2. WTS Energy sh.p.k. të vazhdojë të operojë HEC Selcë deri në licencimin e personit në pronësi të të cilit kalon HEC Selcë.
3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, si dhe të informojë personin, në pronësi të cilit ka kaluar HEC Selcë, lidhur me dokumentacionin që nevojitet për licencim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.6, datë 20.1.2010

PËR NDRYSHIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “HIDROINVEST 1” SHPK ME SERI PV08K, NR.66, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.113, DATË 24.09.2008

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 15, pika 4, geramat “a” dhe “b” të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Hidroinvest 1” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr.66, seria PV08K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.113, datë 24.9.2008 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

dhe konstatoi se:

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hidroinvest 1” sh.p.k. ka nisur me marrjen e vendimit nr.87, datë 10.11.2009.

- Është paraqitur i plotë dokumentacioni për këtë procedurë siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

VENDOSI:

1. Të ndryshojë licencën me numër nr.66, seria PV08K, aneksi A, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.113, datë 24.9.2008, të mbajtur nga shoqëria “Hidroinvest 1” sh.p.k.

2. Kapaciteti i instaluar i HEC Stranik bëhet 4600 kW. Kapaciteti i instaluar i HEC Zall Tore bëhet 3000 kW.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.7, datë 25.1.2010

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE PËR ZONAT E PËRMBYTURA NË QARQET SHKODËR DHE LEZHË

Në mbështetje të neneve 9 dhe 12 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 25.01.2010, mbasi shqyrtoi propozimin e kryetarit të ERE-s për shprehjen e solidaritetit nëpërmjet derdhjes nga fondet e ERE-s së një kontributi financiar në fondet e emergjencës së qeverisë shqiptare,

VENDOSI:

1. Të hapet zëri shpenzime (me numër llogarie 687 shuma të parashikuara të jashtëzakonshme) në projektbuxhetin e ERE-s për vitin 2010 me vlerën 100 000 lekë për dhënie ndihme financiare për zonat e përmbytura në qarqet Shkodër dhe Lezhë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Administrim-Financës dhe Marrëdhënieve me Jashtë ta derdhë këtë kontribut në fondet e qeverisë shqiptare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

KËRKESË
Nr.478, datë 25.1.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rragam-Kam-Tropojë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit për tokën bujqësore (pemëtore) dhe kulturat bujqësore është 160428 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e tetë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E NR. TË PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I AKSIT RRUGOR
“RRAGAM-KAM, TROPOJË”

Nr.	Pronari			Zona kad.	Nr.pas	Sip m ²	Çmimi lekë	Vlera lekë	Vlera për kultura bujq. dhe drutfrutorë	Lloji i pasurisë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Din	Sali	Qeleposhi	3490	747/2	158	206	32548		Pemëtore	Konfirm. nga ZRPP
2	Dem	Sali	Qeleposhi	3490	747/3	148	206	30488		Pemëtore	Konfirm. nga ZRPP
3	Rrustem	Bajram	Çelaj	3490	747/4	201	206	41406	29000	Pemëtore	Konfirm. nga ZRPP
4	Hysni	Shefqet	Rrustaj	3490	645/1	90	206	18540		Pemëtore	Konfirm. nga ZRPP
5	Hysni	Shefqet	Rrustaj	3490	645/2	41	206	8446		Pemëtore	Konfirm. nga ZRPP
						638		131428	29000		
	Shuma								160428		

KËRKESË

Nr.9413/4, datë 1.2.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme, të tipit: tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe “kulturave bujqësore” që preken nga “Ndërtimi i linjës së tensionit të lartë 400 kv, Tiranë 2 – Elbasan 2”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është: “Operatori i sistemit të transmetimit” sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi kërkojmë të vemë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15-ditëve pas publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore, kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Dritan Prifti



OPERATORI I SISTEMIT TRANSMETIMIT/DPZH

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS ELEKTRIKE 400 KV "TIRANA 2"-ELBASAN 2"
BASHKIA E ELBASANIT ZONA FUSHË-MBRET**

Objekti		LISTA E PRONAREVE PER SHPRONESIM DEFINITIV (objekti i shpronësim.;sip.banese nen linje, sip.shtylle)											Kompensimi ne leke i demit te kulturave bujqesore				Vlera totale ne leke	Shenime	
Numri i shtylles	Emri	Atesia	Mbiemri	Lloji i pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Prona ne m2 (totale)	Sip. banese m2	Cmimi Banese ZRPP leke/ m2	Sip shtylle m ²	Cmimi i tokes leke/ m2	Vlera e kompensimit leke	Sip rreth shtylle m ²	Sip.per rruge provizore m ²	Lloji i kultures	Vlera ne leke per kulturen bujqesore			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	15	16	17	18	19	20	
1	107	I paidentifik.		are	K-34-101-(178-B)						54	9451	699374	800	200	grure	12000	711374	nuk ka inform
2	108	Alimsha		Hajro	K-34-101-(178-B)						58	9451	548158	400	1000	grure	16000	564158	nuk ka inform
3	109	Bukurije	Rahman	Kapllani	K-34-101-(178-B)	389/11					65	9451	614315	1200	1200	grure	28000	642315	nuk ka inform
	mes 109-110	I paidentifik		banese ne ndert	K-34-101-(178-D)	F.Mbret			100	46360			4636000					4636000	nuk ka inform
	mes 109-110	I paidentifik		banese	K-34-101-(178-D)	F.Mbret			100	46360			4636000					4636000	nuk ka inform
	mes 109-110	I paidentifik.		banese ne ndert	K-34-101-(178-D)	F.Mbret			100	46360			4636000					4636000	nuk ka inform
	mes 109-110	Namik	Abedin	Pepa	K-34-101-(178-D)	F.Mbret			290	46360			13444400					13444400	nuk ka inform
4	110	Maliq	Gani	Qerimi	K-34-101-(178-D)	pronesi e D.R.B.U.M. Elb.					96	9451	907296	1000	1000	hurma jonxhe	84700	991996	nuk ka inform
5	111	shtet			K-34-101-(178-D)						98								nuk ka inform
6	112	shtet			K-34-101-(178-D)						100								nuk ka inform
									590		471								
									SHUMA TOTALE		273		30121543				140700	30262243	



OPERATORI I SISTEMIT TRANSMETIMIT/DPZH

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS ELEKTRIKE 400 KV "TIRANA 2"-ELBASAN 2"
QARKU ELBASAN KOMUNA BRADASHESH**

Objekti	LISTA E PRONAREVE PER SHPONISIM DEFINITIV (objekti i shpron; sip.banese nen linje, sip.shtylle)												Kompensimi ne leke i demit te kulturave bujqesore				Vlera totale ne leke	Shenime	
	Numri i shtylles	Emri	Atesia	Mbiemri	Lloji i pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Prona ne m2 (totale)	Sip. banese m2	Cmimi Banese ZRPP leke/ m2	Sip shtylle m ²	Cmimi I toke leke/ m2	Vlera e Kompensimit leke	Sip rreth shtylle m ²	Sip. rruge provizore m ²	Lloji i kultures			Vlera ne leke per kulturen bujqesore
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	15	16	17	18	19	20	
	ULEM																		
1	89	Bashkim	Cali	Cani	are	K-34-101-(129-A)					140	359	50260	400		grure	12000	62260	nuk ka inform
		Vathar	Kalem	Cani	are	K-34-101-(129-A)					46	359	16514	200		grure	6000	22514	nuk ka inform
2	90	Shefqet	Arif	Sula	are	K-34-101-(129-C)					64	359	22976	400		grure	12000	34976	nuk ka inform
	prane 91	Jonuz	Sabri	Meta	banese	k-34-101-(129-C)	79/5		170	32452			5516840					5516840	nuk ka inform
	prane 91	Kasem	Hysen	Meta	banese	k-34-101-(129-C)	79/6		120	32452			3894240					3894240	nuk ka inform
3	91	Jonuz	Sabri	Meta	pyll.duhan	K-34-101-(129-C)					77	359	27643	600		duhan+5rrenje qersh	55500	83143	nuk ka inform
	mes 91-92	Ramazan	Ismail	Sula	banese	k-34-101-(129-C)	102/9		120	32452			3894240					3894240	nuk ka inform
	mes 91-92	Shaqir	Islam	Kalashi	banese	k-34-101-(129-C)	102/2		130	32452			4218760					4218760	nuk ka inform
4	92	shtet			pyll shkurre	K-34-101-(145-A)					77			800					nuk ka inform
	Shtemaj																		
5	93	Rrapush		Myzyri	are	K-34-101-(145-A)	109/2	1500			99	296	29304	600		grure	18000	47304	konfirm.zrpp
6	94	Bashkim	Ismail	Hasa	are	K-34-101-(145-A)	125/3	2380			131	296	38776	800		80 rrenj rrush,kum bull.10 rrenj	257000	295776	konfirm.zrpp
7	95	shtet			shkurre	K-34-101-(145-D)	315				36			200		shkurre			konfirm.zrpp
	Recan																		
8	96	Fadil	Demir	Leka	are	K-34-101-(145-D)	74				34	301	10234	1600		25 rrenje ullinj,rrush 30,qersh	346000	356234	nuk ka inform
9	97	shtet			koder	K-34-101-(145-D)	60,61,67				60			800					nuk ka inform
10	98	Osman	Bajram	Gava	are	K-34-101-(161-B)	44,193				113	301	34013	800	200	rrush 6,arra 2,kum bull a4,fiq	87000	121013	nuk ka inform

													8.grure.										
	Shijon																						
11	99	Ilija	Anastas	Gega	are	K-34-101-(161-B)	5											ullinj 10 rrenje qershi 20 rrenje rrush 30 rrenje.				nuk ka inform	
	rruge	Dhimiter	Vasil	Rranxho			pese/33											rrush 10,hurma10	244000	275248		nuk ka inform	
12	100	Engjell	Dhimiter	Gjika	are	K-34-101-(161-B)	120/1											sere 800m2 domate 800m2	450000	492160		nuk ka inform	
		Ndricim	Lipi	Gjika			120/1											sere 600m2 domate 600m2,hurma 20r.	375000	375000		nuk ka inform	
13	101	Dhimiter	Thanas	Gega	are	K-34-101-(162-C)	11/10,9,8,7,											rrush 80 rrenje,kajs i 4 rrenje	246000	304032		nuk ka inform	
14	102	Ilija	Anastas	Gega	are	K-34-101-(162-C)	119/1											grure	79200	127808		nuk ka inform	
15	103	Qemal	Nezir	Mullahu	are	K-34-101-(162-C)	240/7,8,15											grure	24000	88643		nuk ka inform	
		Sali	Musa	Sharra	are		240/10											grure	12000	27270		nuk ka inform	
	rruge	Rexhep	Ismail	Sharra	are		240/11											600 jonxhe	12000	12000		nuk ka inform	
	rruge	Halil	Musa	Sharra	are		287											800 jonxhe	16000	16000		nuk ka inform	
16	104	Xhemal	Qazim	Hidri	are	K-34-101-(162-C)												grure	12000	31305		nuk ka inform	
		Zaim	Arif	Gjoni	are													120 jonxhe	40000	91480		nuk ka inform	
17	105	Ramazan	Jonus	Sinani	are	K-34-101-(178-A)	544/4											rrush 100 rrenje,kum bulla 10 rrenje,ullinj 6 rrenje	353000	405510		nuk ka inform	
	rruge	Enver	Beqir	Myrto	are		544/4											rrush 30 rrenje,kum bulla 10 rrenje,	108000	108000		nuk ka inform	
	rruge	Iiir	Beqir	Myrto	are													kumbulla 10 rrenje	19000	19000		nuk ka inform	
	mes 104 -105	Mustafa	Musa	Sharra	magazine	k-34-101-(178-A)	545/2	120	64904										7788480		7788480		nuk ka inform
	mes 105 -106	Qemal	Emin	Rama	banese	k-34-101-(178-A)	35/5	100	32452										3245200		3245200		nuk ka inform
	mes 105 -106	Bujar	Emin	Gjata	magazine	k-34-101-(178-A)	34/1	120	64904										7788480		7788480		nuk ka inform
18	106	Iiirjan	Emin	Gjata	are	K-34-101-(178-A)	52/7,52/8											grure	24000	52480		nuk ka inform	
								880	1744														
						Shuma totale		880	1507										36987696		2857700	39845396	



OPERATORI I SISTEMIT TRANSMETIMIT/DPZH
LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS ELEKTRIKE 400 KV "TIRANA 2"-ELBASAN 2"
KOMUNA GRACEN QARKU ELBASAN

Objekti	LISTA E PRONAREVE PER SHPRONESIM DEFINITIV (objekti i shpronesimit; sip.banese nen linje, sip.shtylle)												Kompensimi ne leke i demit te kulturave bujqesore				Vlera totale ne leke	Shenime	
	Numri i shtylles	Emri	Atesia	Mbiemri	Lloji i pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Prona ne m2 (total)	Sip. banese m2	Cmim Banese ZRPP leke/ m2	Sip shtylle m²	Cmimi toke leke/ m2	Vlera e kompensimit leke	Sip rreth shtylle m²	Sip. per rrugë provizore m²	Lloji i kultures			Vlera ne leke per kulturen bujqesore
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
	Mamel																		
1	76	shtet			liv shkurre	K-34-101-(112-A)	95				34,8			800					nuk ka inform
2	77	shtet			liv shkurre	K-34-101-(112-B)	95				34,8			800					nuk ka inform
3	78	shtet			liv shkurre	K-34-101-(112-B)	95				46,9			800					nuk ka inform
4	79	shtet			pyll lisi	K-34-101-(112-B)	95				46,9			800					nuk ka inform
5	80	shtet			shkurre	K-34-101-(112-D)	95				72,2			800					nuk ka inform
6	81	shtet			liv shkurre	K-34-101-(112-D)	95				94			800					nuk ka inform
7	82	shtet			pyll pishe	K-34-101-(112-D)	95				89,3			800					nuk ka inform
	Dopoje																		
8	83	shtet			pyll pishe	K-34-101-(128-B)	176				88,3			800					nuk ka inform
	rruge	Ramiz	Hasan	Haka	are		43	39906						300		duhan,ullinj 5 rrenje	68000	68000	nuk ka inform
	rruge	Ali	Hasan	Haka	are		42							300		duhan,ullinj 3 rrenje	43000	43000	nuk ka inform
9	84	shtet			pyll pishe	K-34-101-(128-B)	176				40			800					nuk ka inform
10	85	shtet			shpat kodre	K-34-101-(128-B)	695				101			800					nuk ka inform
11	86	Xhemal	Reshat	Taci	are	K-34-101-(113-C)	758, 764				100	396	39600	800	100	grure	10800	50400	nuk ka inform
	mes 86-87	Gezim	Kalem	Drufi	banese	K-34-101-(113-C)			130	32452			4218760					4218760	
12	87	Azem	Selim	Leka	are	K-34-101-(129-A)	363/3				98	396	38808	800	500	grure	15270	54078	nuk ka inform
	Shengjin																		
	afer 88	Shkelqim	Ramazan	Haka	banese	K-34-101-(129-A)	520		230	32452			7463960					7463960	nuk ka inform
13	88	Myslim	Sulejman	Bunga	are	K-34-101-(129-A)	541	1700			128	259	33152	1000	1200	grure	26400	59552	nuk ka inform
	mes 88-89	Myslim	Sulejman	Bunga	banese		534		222	32452			7204344					7204344	nuk ka inform
	mes 88-	Qamil	Hysen	Lleshi	banese	K-34-101-	574		210	32452			6814920					6814920	nuk ka inform

	89					(129-A)													
	mes 88-90	Nuredin		Haka	banese	K-34-101-(129-A)			135	32452			4381020					4381020	
	mes 88-89	Sami	Tahir	Hasa	banese	K-34-101-(129-A)	592		150	32452			4867800					4867800	nuk ka inform
	mes 88-89	Sami	Tahir	Hasa	banese	K-34-101-(129-A)	594		40	32452			1298080					1298080	nuk ka inform
	mes 88-89	Ali	Tahir	Hasa	banese 2kat	K-34-101-(129-A)	598		304	32452			9865408					9865408	nuk ka inform
									1421			326							
									SHUMA TOTALE										
									904.6				46225852					163470	46389322

KËRKESE

Shetasi Besim Llani, i biri i Hysenit dhe i Ikes, i datëlindjes 1940, lindur dhe banues në Tiranë, kërkon shpalljen të zhdukur e më pas të vdekur të vëllait të tij, shtetasit Ramazan Llani.

KËRKUES
Besim Llani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 8.2.2010
Doli nga shtypi më 10.2.2010

Tirazhi: 3000 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 38 lekë